



Prishtinë: 02.09.2021

Kodi i ZRRE-së: V\_1374\_2021

## Bordi i Zyrës së Rregullatorit për Energji

### Duke u bazuar në:

- Nenin 9, paragrafi 1, nën-paragrafi 1.7, nenin 15 dhe 17 të Ligjit për Rregullatorin e Energjisë (Nr. 05/L-084);
- Nenin 17 dhe 18 të Rregullës për Zgjidhjen e Ankesave dhe Kontesteve në Sektorin e Energjisë;
- Vendimi i DMK-së të ZRRE-së: **ZRRE/DMK\_V\_2156\_03\_21** i dt.31.03.2021;
- Kundërshtimi i KESCO-s i datës **11.05.2021**;

në seancën e mbajtur më datë **02.09.2021** nxori këtë:

### V E N D I M

- I. **REFUZOHET** kundërshtimi i KESCO-s ndaj vendimit të DMK-së, për konsumatorin N.D nga Komuna e Gjilanit, me shifër të konsumatorit DGL - 2001019, si e pabazuar.
- II. **MBETET në fuqi**, vendimi i Departamentit për Mbrojtjen e Konsumatorëve në ZRrE, me nr. ZRrE/DMK\_V\_2156\_03\_21, i datës 31.03.2021.

### A r s y e t i m

Departamenti për Mbrojtjen e Konsumatorëve në ZRrE, me datë 31.03.2021 ka marrë Vendim me nr. ZRrE/DMK\_V\_2156\_03\_21 me të cilin e ka aprovuar ankesën e konsumatorit N.D, nga Komuna e Gjilanit dhe e ka obliguar të Licencuarin KESCO që t'i anulojë faturat 11/2015, 12/2015, 01/2016, 02/2016 dhe 03/2016 dhe për këto periudha ta fatojoj konsumatorin me shpenzimet e periudhave 11/2017, 12/2017, 01/2018, 02/2018 dhe 03/2018.

I pakënaqur me Vendimin e DMK-së, i licencuari KESCO, brenda afatit ligjor ka paraqitur Kundërshtim në Bordin e ZRrE-së, për këto shkaqe:

- Faturat e kontestuara janë më të larta, por kjo nuk do të thotë që konsumatori nuk e ka shpenzuar energjinë elektrike të faturuar. Leximet e bëra për këtë periudhë janë lexime me sondë dhe pajisjet HHU, ku të dhënat janë marrë në mënyrë automatike dhe në këtë mënyrë evitohet gabimi në lexim.
- Konsumatori ka ndryshime dhe dallime të mëdha në shpenzim të energjisë përgjatë viteve, andaj edhe arsyetimi i DMK-së nuk mund të konsiderohet si shpenzim real.
- Shqyrtimi i njehsorit nga Qendra e Kalibrimit dhe rezultati se gabimi në matje është +0.33% është fakt shumë i rëndësishëm dhe real se matja me këtë njehsor është e saktë.
- Apeluesi KESCO kërkon nga Bordi i ZRRE-së që pezullojnë vendimin e DMK-së ZRRE/DMK\_V\_2156\_03\_21 i datës 31.03.2021 për konsumatorin N.D.



Bordi i Zyrës së Rregullatorit për Energji në mbledhjen e mbajtur me datë 02.09.2021 ka analizuar të gjitha shkresat e lëndës të prezantuara nga palët në kontest, si dhe vendimin e Departamentit për Mbrojtjen e Konsumatorëve dhe pas kësaj ka vërtetuar se vendimi i DMK-së si vendim i shkallës së parë është vendim i drejtë dhe i bazuar në prova konkrete.

Lidhur me pikën e kundërshtimit të KESCO-s në të cilën pretendohet se faturimi për periudhat kontestuese është i saktë, Bordi i ZRrE-së këtë pretendim e vlerëson si jo të qëndrueshëm, për faktin se, pas analizimit të Rrjedhës së Energjisë se vërehet se konsumatori ka pasur në funksion 4 njehsor elektrik: nr.62197486, nr.64694405, nr.69074684 dhe nr.55275813. Bazuar në analizën e bërë shpenzimit të energjisë elektrike shihet se konsumatori ka lexim dhe faturim të rregullt të pikës matëse. Bordi po ashtu ka analizuar me kujdes shpenzimin e energjisë elektrike të konsumatorit të periudhës kontestuese 11/2015, 12/2015, 01/2016, 02/2016, dhe 03/2016 me njehsorin nr.62197486 me periudhat e njëjta të njëjtit njehsor dhe njehsorëve tjerë dhe ka vërejtur se ndryshim në shpenzimin e energjisë elektrike. Nga rrjedha e energjisë elektrike shihet se mesatarja mujore e shpenzimit të energjisë elektrike e periudhës 11/2014 – 03/2015 me njehsorin nr. 62197486 është **320.40 kWh/muaj**, mesatarja mujore e shpenzimit të energjisë elektrike e periudhës kontestuese 11/2015 – 03/2016 me njehsorin nr.62197486 është **1561.60 kWh/muaj**, mesatarja mujore e shpenzimit të energjisë elektrike e periudhës 11/2016 – 03/2017 me njehsorin nr. nr.64694405 është 159.60 kWh/muaj, mesatarja mujore e shpenzimit të energjisë elektrike e periudhës 11/2017 – 03/2018 me njehsorin nr.64694405 është 539.4 kWh/muaj, mesatarja mujore e shpenzimit të energjisë elektrike e periudhës 11/2018 – 03/2019 me njehsorin nr. nr.64694405 është 778.8 kWh/muaj, mesatarja mujore e shpenzimit të energjisë elektrike e periudhës 11/2019 – 03/2020 me njehsorin nr.69074684 është 321.2 kWh/muaj. Pra sipas analizave të bëra shpenzimit të energjisë elektrike të periudhës kontestuese me periudhat tjera para dhe pas kësaj periudhe, shihet qartë **se ka ndryshim në shpenzimin e energjisë elektrike.**

Argumenti tjetër i të licencuarit se konsumatori ka ndryshime në shpenzim përgjatë viteve, Bordi nuk e kundërshton në parim, mirëpo thekson se janë relativisht më të vogla në krahasim me shpenzimet e periudhës kontestuese të paraqitur si më lartë, (p.sh., si 11/2014 – 03/2015 = 320.40 kWh/muaj, pastaj 11/2017 – 03/2018 = 159.60 kWh/muaj e të ngjashme) dhe as për së afërmi nuk përkojnë me shpenzimet e faturuara për periudhën kontestuese.

Bazuar në të gjitha analizat e bëra, përfshi edhe procesverbalet e ndërrimit të njehsorit elektrik të cekura më lartë, protokollin e shqyrtimit të njehsorit elektrik dhe rrjedhën e energjisë elektrike ku shihet se ka ndryshim në shpenzimin e energjisë elektrike të periudhës kontestuese në krahasim me periudhat tjera para dhe pas periudhës kontestuese, Bordi konstaton se faturimi i konsumatorit për periudhat 11/2015, 12/2015, 01/2016, 02/2016, dhe 03/2016 me njehsorin nr.62197486 nuk paraqet shpenzim real të konsumatorit, dhe si rrjedhojë këto fatura duhet të shkarkohen dhe se për këto periudha konsumatori duhet të faturohet me shpenzimet e periudhave 11/2017, 12/2017, 01/2018, 02/2018 dhe 03/2018.

Bordi i ZRRE, gjithashtu ka konstatuar se përfaqësuesi i autorizuar i KESCO-së në ankesën e tij nuk ka ofruar asnjë provë bindëse për të vërtetuar faktin se vendimi i DMK-së si organ i shkallës së parë nuk



është vendim i drejtë dhe i bazuar në ligje dhe rregulla, por që i njëjti në ankesë vetëm se ka kontestuar vendimin e shkallës së parë në mënyrë të përgjithësuar pa ofruar prova të arsyeshme.

Bordi i ZRRE-së në mbledhjen e mbajtur me datë 02.09.2021 pas analizimit të gjithë asaj që u theksua më lartë, ka vendosur si në dispozitivin e këtij vendimi.

**III.** Vendimi nxirret në gjuhën shqipe dhe do të përkthehet në gjuhën serbe dhe angleze. Në rast të mospërputhjes në mes të versioneve, do të mbisundojë versioni në gjuhën shqipe.

**IV.** Vendimi hyn në fuqi në datën e miratimit nga Bordi, dhe do të publikohet në faqen elektronike zyrtare të ZRRE-së.

**Këshillë Juridike:** Pala e pakënaqur me këtë Vendim mund të iniciojë konflikt administrativ në Gjykatën Themelore në Prishtinë, Departamenti për Çështje Administrative, brenda tridhjetë (30) ditëve nga data e pranimit të Vendimit ose data e publikimit të tij në faqen elektronike të ZRRE-së, cilado që ndodhë e fundit.

**Vendimi iu dërgohet:**

- KESCO-së,
- Konsumatorit N.D. dhe,
- Arkivit të ZRRE-së

**Bordi i ZRRE-së:**

\_\_\_\_\_  
Ymer Fejzullahu, Kryesues

\_\_\_\_\_  
Selman Hoti, anëtar

\_\_\_\_\_  
Izet Rushiti, anëtar

\_\_\_\_\_  
Lutfije Dervishi, anëtare

\_\_\_\_\_  
Gani Buçaj, anëtar